

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	DETAJET+PAMJET nga atentati në Athinë! Lokali në pronësi të Denis Lulit, urdhri dyshohet të jetë dhënë nga Klod Cara
ADRESA	https://lajmifundit.al/detajet-pamjet-nga-atentati-ne-athine-lokali-ne-pronesi-te-denis-lulit-urdhri-dyshohet-te-jete-dhene-nga-klod-cara-i1338827
BURIMI	lajmifundit.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 16:30:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 18:16:38 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	76d786e40151a00fc872835c48108da4fcd4a77a31fa3774bc104e5f820bacf7
TEKSTI	4c2712c695cd138a5e7f22639a40ce7d608699ab3aa3b278cb63788722dd9ca7
PAMJA	4e4ae654e7cd6595fcaa5e86cc30302908ab5e4015ed424317eb16ecd5539d5e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	da1651b0577ab46da8bab0c4cc96febad3b229dbae83af7bbe94b6fb4a54f38a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f11c1668384a0114026088dd439e5bbabdb3d48a586475de97c9d12c35b4ba6b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/da1651b0577ab46da8bab0c4cc96febad3b229dbae83af7bbe94b6fb4a54f38a

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

EMRI / 49-vjeçari i jep fund jetës duke u varur me litar në burgun e Reçit, ishte i dënuar për vrasjen e bashkëshortes [Lexo lajmin e plotë](#) →

DETAJET+PAMJET nga atentati në Athinë! Lokali në pronësi të Denis Lulit, urdhri dyshohet të jetë dhënë nga Klod Cara [Lexo lajmin e plotë](#) →

"Vlora Hyseni me Agasin u njohën në Kryeministri"- Gazetari Artan Hoxha: Rama i mori të dy këshilltarë dhe i parapërgatiti [Lexo lajmin e plotë](#) →

Tre të rinjtë shqiptarë humbën jetën në Greqi, dëshmia rrëqethëse e mikes së familjes [Lexo lajmin e plotë](#) →

PD letrë zyrtare Peleshit: Zbatoni vendimin e Kushtetueses për Komisionin Hetimor të zgjedhjeve të 11 majit [Lexo lajmin e plotë](#) →

DETAJET+PAMJET nga atentati në Athinë! Lokali në pronësi të Denis Lulit, urdhri dyshohet të jetë dhënë nga Klod Cara



LAJMI FUNDIT / 26 SEPTEMBER 2026, 18:16

Shpërndaje

KOSOV&RAJON



Lokali "Amora", i cili ra pre e sulmit me Kallashnikov mesnatën e së premtes në Athinë, rezultoi në pronësi të 30-vjeçarit Denis Luli. Si pasojë e të shtënave nga një makinë ku udhëtonin 4 persona, u plagos një 10-vjeçare shqiptare, e cila nuk dihet nëse kishte lidhje me pronarin. Ajo ndodhej në vendin e ngjarjes bashkë me nënën e saj, e cila e transportoi privatisht drejt spitalit pas plagës së marrë në pulpë.



Policia gjeti më pas të djegur në Aspropirgo dhe me një Kallashnikov brenda, automjetin e përdorur

MOTI NË TIRANË
Tirana, Albania

POLITIKË

PD letrë zyrtare Peleshit: Zbatoni vendimin e Kushtetueses për Komisionin Hetimor të zgjedhjeve të 11 majit

POLITIKË

Emrat / Ja kush janë 10 ambasadorët e SHBA-së në Shqipëri që prej vitit 1991

TRENDING

Destinacioni sekret: Wizz Air sjell në TIA 150 influencues dhe gazetarë për të zbuluar Shqipërinë

Kryeministri Rama në New York: Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, dëshmi e transformimit të Shqipërisë

në ngjarje. Policia dyshon se shënjestër e sulmit ishte 30-vjeçari Denis Luli, person me precedentë penalë. Ai rezultoi i arrestuar në 2015 në një parcelë të mbjellë me marijuanë, ku gjatë aksionit Luli hapi zjarr ndaj forcave të policisë greke. Për ngjarjen ai u dënua dhe u lirua me kusht në vitin 2021 nga burgu i Malandrinos.

Lidhur me ngjarjen e mbrëmshme, policia dyshon se ajo është porositur nga 49-vjeçari nga Berati, Klodian Lekocaj, i njohur gjerësisht si Klod Cara. Ai rezultoi i burgosur prej vitesh si autor direkt dhe porositor i shumë ngjarjeve të rënda në Greqi.



Kush është Klodian Lekocaj

Klodian Gjon Lekocaj, 49 vjeç, alias Klod Cara, një personazh kontrovers, është kthyer në qendër të vëmendjes vitet e fundit për shkak të etiketimit nga media greke si kreu i së ashtuquajturës “Mafia e Burgjeve”. Se sa realisht ai është i tillë, kjo nuk dihet, pasi vetë ai në daljet publike në media e konsideron veten “të varfër”, “të pafajshëm”, “të përdorur”, ndërkohë që faktet, dëshmitë dhe përgjimet që disponon policia greke të çojnë drejt mendimit se realisht Lekocaj ka pasur dhe ka ende një rol të rëndësishëm në botën e nëndeshme të grupeve kriminale shqiptare dhe greke.

Lekocaj shpesh në përgjime e dëshmi ka dalë se çuditshëm ka lidhur fjetet e grupeve kriminale, duke u vënë ose atyre, ose vetes në dispozicion vrasës me pagesë. I tillë ishte dhe rasti i 14 shtatorit 2022, kur policia greke arrestoi rastësisht dy shqiptarët Viktor Çala, 39 vjeç, dhe Andi Beqiri, 23 vjeç. Ata u kapën në Athinë, pasi në automjetin e tyre u gjetën të fshehura 2 Kallashnikovë dhe 1 thikë, ndërsa në banesë 1 pistoletë. Hetimi i policisë zbuloi se Çala ishte autor i vrasjes së një greku dhe tentativës së vrasjes së një shqiptari, të dyja ngjarje të ndodhura në muajin korrik 2022.

Për vrasjen e grekut ai deklaroi se ishte urdhëruar nga Klodian Lekocaj, për shkak të prishjes së pazareve të drogës. Kështu “Klodit”, i cili në kartelat greke njihet edhe si “Luli” apo “Ilia”, iu shtua atëherë edhe një akuzë tjetër pas akuzave të mëparshme për urdhërimin e vrasjeve të avokatit grek Mixalis Zafirooulos, të të burgosurit Arbër Bako, të të burgosurit Bardhyl Tusha, përfshirje në tentativën e vrasjes së një pakistanezi, gjobëvënie ndaj ish-Ministrit grek Dimitri Tsovola, ndihmë në arratisjen e të burgosurve Leonard dhe Elvis Pepa etj. Klodi, në fakt, veç urdhrave, ka precedentë dhe si autor i drejtpërdrejtë.



POLITIKË

Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, priti sot Ambasadorin e ri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Eric Wendt

POLITIKË

Berisha hedh deklaratën e fortë: E tradhëtuan, Vlora Hyseni erdhi në Shqipëri për tu dhënë reston bashkëpunëtorëve

ME TE LEXUARAT

“Zbrazti karika’torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi” – Mediat italiane: Jeta e “dyfishtë” e...

[Lexo lajmin e plotë](#)

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026

[Lexo lajmin e plotë](#)

Skandali “Xhaka” merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë

[Lexo lajmin e plotë](#)

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!

[Lexo lajmin e plotë](#)



Fillimisht është arrestuar në 1997 për vjedhje. Në 2003 ishte arratisur nga Burgu i Volos, ndërsa në 2005, në Agio Pantaleimona, plagosi me armë zjarri në bark një shqiptar e më pas, në të njëjtin vend, në 2006, bashkë me dy shqiptarë plagosi me thikë një bashkëkombës të tijin. Në 2013 u arrestua për trafik droge dhe vjedhje dhe u dërgua në burgun e Korfuzit, ku pasi mori leje u arratis në 2014 dhe, pas disa ditësh, bashkë me Arbër Bako mori pjesë në tentativën e grabitjes, me pasojë plagosjen e një egjiptiani, ndërsa më 31 tetor 2014, bashkë me Arbër Bako, Olti Dulce dhe një polak, kryen një vrasje në zonën e Metaksurgios.

Përfundimisht, Lekocaj u arrestua në nëntor 2014 në Sepolia, në shoqërinë e Dhimo Mëcit, një gjirokastrit i përfshirë në disa vrasje me pagesë në Greqi dhe që në momentin e kapjes ishte person në kërkim. Arrestimi i tyre erdhi pas ngjarjes së Mikrolimanos, ku Arbër Bako, me një Kallashnikov, plagosi disa klientë të një lokali në zonë.

Klodian Lekocaj është përmendur të ketë pasur lidhje edhe me shqiptarët Elvis Bogdani dhe Ari Papa, të ekzekutuar më parë në Greqi.

Në 2019, Lekocaj u akuzua se rekrutoi një vrasës me pagesë nga Shqipëria për të ekzekutuar një pakistanez, ndërsa në mars 2023 ndaj Lekocajt u ngrit akuzë për gjobëvënie 100 mijë euro ndaj një biznesmeni grek.



Në prill 2025, Lekocaj u akuzua për porositjen e atentatit ndaj shqiptarëve Kristjanis Stefa dhe Florian Bajraktari, ndodhur më 23 shtator 2024.

LEXONI GJITHASHTU



**"Vlora Hyseni me Agasin u njohën në Kryeministri"-
Gazetari Artan Hoxha: Rama i mori të dy këshilltarë
dhe i parapërgatiti**



**Tre të rinjtë shqiptarë humbën jetën në Greqi,
dëshmia rrëqethëse e mikes së familjes**



**PD letrë zyrtare Peleshit: Zbatoni vendimin e
Kushtetueses për Komisionin Hetimor të zgjedhjeve
të 11 majit**

Në maj 2025, Lekocaj mori peng dy gardianë të burgut të Koridhalos përmes një thike, duke u marrë çelësat, radiot dhe telefonat celularë. Ai filloi të lëvizte drejt një sektori tjetër të burgut bashkë me 7 egjiptianë, me qëllim futjen në repartin 3, ku dyshohet se do të tentonte vrasjen e një shqiptari. Ndërhyrja e forcave të tjera ndihmoi në neutralizimin e të burgosurve.

Disa ditë më pas, policia ushtroi kontroll në qelinë e Lekocajt dhe disa të dënuarve të tjerë, duke

gjetur sende të paligjshme si celularë, thika e kokainë.

Në shkurt 2026, policia zbuloi se Lekocaj qëndronte pas një rrjeti të futjes së drogës në burg dhe e arrestoi atë bashkë me tre të tjerë.

Po në këtë muaj, Lekocaj mori përsipër autorësinë e plagosjes në burg të vrasësit shqiptar me pagesë, 46-vjeçarit Dhimo Meci. Lekocaj deklaroi se kishte urdhëruar autorin grek për të kryer krimin.

Në prill 2026, policia greke arrestoi në Agio Pantaleimona, në Athinë, dy të rinj shqiptarë shpërndarës droge dhe sekuestroi një sasi. Pas tyre qëndronte me urdhra pikërisht Klodian Lekocaj.

Po në këtë muaj, policia greke arrestoi në Selanik 3 persona për gjobëvënie ndaj një biznesmeni. Të arrestuarit ishin dy shqiptarë dhe një grek, që kishin marrë urdhra nga Lekocaj. Njërit prej të arrestuarve iu sekuestrua edhe një pistoletë.

Në shtator 2026, dy lokale u sulmuan me granata në qendër të Athinës, në distancë 30 min nga njëra-tjetra. Grupi hetimor dyshon se pas ngjarjeve fshihet pikërisht Klodian Lekoca

ME TE LEXUARAT

“Zbrazì karika’torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi” – Mediat italiane: Jeta e “dyfishtë” e Gjovalin Lazrit

[Lexo lajmin e plote](#)

NA SHKRUAJ

Portali Lajmifundit sjell Lajme nga Shqipëria, rajoni dhe bota në kohë rekord. Ju lutemi na kontaktoni nëse doni të kontribuoni me informacione të vlefshme për publikim në portalin tonë.

[Kliko për më shumë informacion](#)

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026

[Lexo lajmin e plote](#)

Skandali “Xhaka” merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë

[Lexo lajmin e plote](#)

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!

[Lexo lajmin e plote](#)

“Askush nuk është mbi ligjin”/ Rama shkarkon menjëherë Vlora Hysenin: Pas kthimit në Tiranë zgjedh drejtuesin e ri të SHISH

[Lexo lajmin e plote](#)

Sekuestrohet hoteli “Central Park Premium” në Ksamil, u ndërtua pa leje! Ja kujt i përket

[Lexo lajmin e plote](#)

“Ka gjëra që edhe ne që i dimë nuk flasim dot”/ Artan Hoxha: Ka fakte tronditëse për Ballukun, gropa u hap

[Lexo lajmin e plote](#)

LajmiFundit merr pjesë në programe të ndryshme marketingu ku mund të përfitojë komisione për produktet e zgjedhura në artikujt e publikuar.

Created & Monetized by **Mediadesk**

OK

Ju do të merri njoftime periodike me Lajmet e Fundit.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.